



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

TË DHËNA MBI VENDIMIN Nr. 82, Datë 30.11.2023

MONITORIM I KYER NGA APP

Autoriteti kontraktor	MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
Hetim Administrativ, iniciuar nga	• APP X • Reklamim nga të tretë
Numri i kontratave	1 (një)
Konstatimet kryesore	1. APP vlerëson se plani i zbatimit të kontratës ka mangësi në hartimin e tij, përse i përket çështjeve organizative e teknike të kontratës, që lidhen me monitorimin e zbatimit të saj, sipas kushteve të prokuruar. 2. Autoriteti Kontraktor nuk ka vepruar në përputhje me pikën 1, të nenit 124, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, si dhe pikës 7, të nenit 107, të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, pasi nuk ka administruar gjatë zbatimit të kontratës gjithë dokumentacionin e nevojshëm të parashikuar në dokumentet e tenderit dhe në kontratë, si dhe nuk ka kryer verifikimet përkatëse, për të siguruar që malli i dorëzuar i plotëson kërkesat e cilësisë, në përputhje me kushtet e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe në kontratë, për të cilat është shpallur fitues kontraktori. 3. Procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit ka mospërputhje të dhënash dhe nuk është i rregullt sipas parashikimeve të

	legjislacionit në fuqi. Gjithashtu, hyrja e mallrave në magazinë nuk është dokumentuar menjëherë pas marrjes në dorëzim të mallit, me fletëhyrjen përkatëse, në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit në fuqi. 4. Hartimi i kontratës nuk është bërë në përputhje me kushtet e prokuruaras përsa i përket vlerës së një artikulli. Gjithashtu, nuk janë kryer verifikimet përkatëse për të evidentuar mospërputhjet në sasinë dhe vlerën e mallit të marrë në dorëzim, me sasinë dhe vlerën e paraqitur në faturën e lëshuar nga kontraktori, duke kryer pagesën për një vlerë më të madhe se vlera që i korespondon sasisë reale të artikullit që është marrë në dorëzim.
Masat e marra	Në bazë të neneve 23, gërma “e”, dhe 132, pika 1, gërma “k/l”, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, APP vendosi të dënojë me gjobë 5 persona përgjegjës për marrjen në dorëzim dhe ndjekjen e zbatimit të kontratës dhe 1 person përgjegjës për financat, për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim. Në bazë të neneve 23, gërma “e”, dhe 132, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, APP vendosi të propozojë marrjen e masës disiplinore ndaj 3 personave përgjegjës për marrjen në dorëzim, 1 personi përgjegjës për hartimin e kontratës dhe 1 personi në cilësinë e punonjësit me përgjegjësi materiale, për shkeljet dhe mangësitë e konstatuara në vendim.